



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 54
Prishtinë, më 29 mars 2012

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29, 30 MARS DHE 5 e 6 PRILL 2012**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Sabri Hamiti** nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë.

Në vazhdim, lidhur me propozimet për ndryshimin e rendit të ditës, për fjalë u paraqitën deputetët: Safete Hadergjonaj, Zenun Pajaziti dhe Idriz Vehapi.

Safete Hadergjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, propozoi që në rendin e ditës së sotme të radhitet pika – **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.**

Në lidhje me propozimin e lartpërmendur diskutuan këta deputetë: Arben Gashi - në emër të Komisionit për Legjislacion, Adem Grabovci - në emër të GP të PDK-së, Hykmete Bajrami - në emër të GP të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të GP të lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të GP të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të GP të Koalicionit Kosova e Re, Jelena Bontiq - në emër të GP SLS, Albert Kinolli - në emër të GP “6+”, Ismet Beqiri dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari hodhi në votim propozimin që në rendin e ditës së sotme të radhitet pika – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 45,
Kundër----- 32,
Abstenime----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi propozimin që në mbledhjen e sotme plenare të radhitet si pikë me nr. 9. - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri kërkoi që pika - Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, të hiqet nga rendi i ditës, me qëllim të konsultimeve me Qeverinë e Kosovës.

Kryetari hodhi në votim propozimin e lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58,
Kundër----- 9,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Shtyhet shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 10/60 dt. 08.02.2012, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, me qëllim të konsultimeve me Qeverinë e Kosovës.

Idriz Vehapi, në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, kërkoi që pika - Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës, të hiqet nga rendi i ditës, dhe ky Propozim-vendim ti kthehet Qeverisë.

Kryetari hodhi në votim propozimin e lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër----- 9,
Abstenime----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Propozim Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/58 dt. 27.01.2012 për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës, i kthehet Qeverisë, për riprocedim.

Në vazhdim, Kuvendi i filloi punimet me këtë

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Bibliotekat në Republikën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lojërat e fatit,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fondet pensionale në Kosovë,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,
10. Kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-168 për Turizmin dhe Shërbimet Turistike,
11. Shqyrtimi Planit Hapësinor i Zonës me interes të veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë”.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Albulena Haxhiu, Duda Balje, Teuta Sahatqija, Bekim Haxhiu, Ardian Gjini, Florin Krasniqi, Nijazi Idrizi, Hashim Deshishku, Hamza Balje dhe Teuta Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri, parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja, në lidhje me zbatimin e projektit për ndërtimin e shkollës së mesme profesionale në Suharekë.

Ministri Ramë Buja, iu përgjigj pyetjes së deputetes Afërdita Berisha-Shaqiri.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me procedimin në Kuvend të pakos së projektligjeve nga lëmia e shëndetësisë dhe sigurimeve shëndetësore.

Ministri Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Valbona Dibra, parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me atë se a ka kapacitete Ministria e Shëndetësisë që në një të ardhme të afërt të pajiset me një laborator prenatal i cili do të ndikonte në zvogëlimin e lindjeve me sindromin down, në Kosovë.

Ministri Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes Valbona Dibra.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtoi pyetje për ministrin Nenad Rashiq, në lidhje me inspektimin e ligjit të punës lidhur me pushimin e lehonisë dhe masat mbrojtëse që duhen zbatuar për nënat lehona, në mënyrë që të mos largohen nga puna.

Ministri Nenad Rashiq, iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Nazane Breca, parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me punimet për rregullimin e hapësirës për klinikën e kardiokirurgjisë, funksionalizimin e saj dhe kur pritet fillimi i punës së klinikës për pacientë.

Ministri Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes Nazane Breca.

Deputetja Hykmete Bajrami, parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaqi, në lidhje me reduktimin e shpenzimeve të Qeverisë, siç janë shpenzimet e karburantit, telefonave, reprezentacionit etj.

Pyetjes së deputetes Hykmete Bajrami iu përgjigj ministri Bedri Hamza

Deputetja Hykmete Bajrami, parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj, në lidhje me pagesat për këshilltarin e transaksionit për privatizimin e PTK-së, aq më parë kur dihet se PTK ka qenë më herët në privatizim.

Ministri Besim Beqaj, iu përgjigj pyetjes së deputetes Hykmete Bajrami.

Deputetja Albana Gashi, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me zbatimin e Udhëzimit Administrativ nr. 04/2008, me theks në qarkullimin e medikamenteve pa fletëudhëzuesin për përdorim në gjuhën zyrtare.

Ministri Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes Albana Gashi.

Deputetja Alma Lama, parashtroi pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri, në lidhje me rezultatet që ka prodhuar dialogu mbi çështjen e personave të zhdukur, për të cilën zëvendëskryeministrja kishte deklaruar se është diskutuar me palën serbe në Bruksel.

Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Alma Lama, parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaqi në lidhje me procedimin në Kuvend të projektligjit për legalizimin e ndërtimeve pa leje.

Kryeministri Hashim Thaqi nuk ishte prezent në sallë.

Deputetja Nazane Breca, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me përzgjedhjen e kompanive kontraktuese për unifikimin dhe standardizimin e dokumenteve shëndetësore, sipas Udhëzimit Administrativ nr. 02/2010.

Ministri Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes Nazane Breca.

Deputetja Kimete Bytyqi, parashtroi pyetje për ministrin Ramë Buja, në lidhje me, siç tha, mos realizimin e ndërtimit të tri shkollave në fshatrat e komunës së Suharekës.

Ministri Ramë Buja, iu përgjigj pyetjes së deputetes Kimete Bytyqi.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtura më 15 mars 2012

Kuvendi, miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 15 mars 2012.

Deputetja Sala Berisha-Shala, propozoi që në të ardhmen transkriptit të mbledhjes plenare t'i bashkohet rendi i ditës.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë.

Raportin e Komisionit funksional për Projektligjit nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Idriz Vehapi.

Kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2 (i plotësuar sipas diskutimit të deputetit Armend Zemaj), 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe amendamentin nr. 21.

Për amendamentin nr.2 diskutoi deputeti Armend Zemaj, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Për amendamentin nr. 5 diskutoi deputeti Danush Ademi, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Për amendamentin nr. 6 diskutuan deputetët: Duda Balje dhe Ardian Gjini, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për amendamentin nr.8 dhe nr.9 diskutuan deputetët: Arben Gashi - në emër të Komisionit për Legjislacion, Idriz Vehapi - në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Eqrem Kryeziu në cilësinë e nënkryetarit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Ardian Gjini, kryetari Jakup Krasniqi dhe Safete Hadërgjonaj – në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për amendamentin nr.16 diskutuan deputetët: Arben Gashi - në emër të Komisionit për Legjislacion, Idriz Vehapi - në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Ardian Gjini dhe Alma Lama, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	42,
Kundër-----	38,
Abstenime-----	3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin nr. 04/L-46 për Radiotelevizionin e Kosovës (RTK).

Në vazhdim, kryetari caktoi pauzë deri në ora 15:00.

Në vazhdimin e punimeve të pasdites për fjalë u paraqitën: Ismet Beqiri- në emër të GP të LDK-së, Visar Ymeri në emër të GP “Vetëvendosje” dhe Ardian Gjini në emër të GP të AAK-së, të cilët deklaruan se në shenjë pakënaqësie me mënyrën e procedimit nuk do të marrin pjesë në vazhdimin e punimeve të kësaj mbledhje plenare. Diskutimet e tre deputetëve të lartpërmendur janë dhënë të plota në transkript.

Pas kësaj grupet parlamentare të tri subjekteve politike opozitare e lëshuan sallën e mbledhjeve.

Kryetari konstatoi se, në mungesë të kuorumit, nuk mund të vazhdojë me punimet e mbledhjes së sotme plenare dhe e mbylli atë në ora 15:30 minuta.

Ndërsa vazhdimin e saj e paralajmëroi për ditën e nesërme, e premte 30 mars 2012, në ora 10:00.

E premte, 30 mars 2012, ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 29 mars 2012 dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm vetëm 45 deputetë.

Në mungesë të kuorumit, kryetari Krasniqi konstatoi se kryetarët e grupeve parlamentare të pozitës nuk janë në nivel të përgjegjësisë të tyre, ndërsa në lidhje me mungesën e opozitës në sallë ai tha se opozita është dashur ta arsyetojë daljen nga salla, ngase deri më tani nuk ka pasur asnjë lloj shkelje procedurale dhe të Rregullores së Kuvendit.

Në mungesë të kuorumit, kryetari Krasniqi konstatoi se Kuvendi nuk mund t'i vazhdojë punimet. Ai tha se do të mbledhet Kryesia e Kuvendit më 2 prill 2012, për të vendosur për datën e vazhimit të seancës plenare.

E enjte, 5 prill 2012, e ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit ndërsa i ndihmoi **Xhavit HALITI** nënkryetar Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 29 mars 2012 dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 77 deputetë.

Kryetari e njoftoi Kuvendin se Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e fundit të mbajtur me kryetarët e grupeve parlamentare i propozon Kuvendit që si pikë nr. 1 e mbledhjes së sotme të jetë **-Informatë e ministrit të Punëve të Brendshme për ngjarjen në kufi me Serbinë, më 31 mars 2012.**

Në vazhdim për fjalë u paraqitën deputetët:

Zenun Pajaziti, në emër të Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, propozoi që në rendin e ditës së mbledhjes së sotme, të futet pika - **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.**

Nait Hasani, në emër të Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, propozoi që në rendin e ditës së mbledhjes së sotme, të futet pika - **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ndërtim**.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, propozoi që pika - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare**, të tërhiqet nga shqyrtimi dhe i njëjti ti kthehet Qeverisë për ripunum. Në të kundërtën grupi që ai përfaqëson do ta lëshojë sallën e mbledhjeve, theksoi deputeti Beqiri.

Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, përkrahu propozimin e paraqitur nga Zenun Pajaziti dhe Nait Hasani.

Visar Ymeri, në emër të GP të lëvizjes “Vetëvendosje”, përkrahu qëndrimin e paraqitur nga kryetari i GP të LDK-së. Grupi që ai përfaqëson është kundër që propozimet për shqyrtim të parë të dy projektligjeve të radhiten për shqyrtim në seancën e sotme plenare, theksoi deputeti Visar Ymeri.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, përkrahu qëndrimin e paraqitur nga kryetari i GP të LDK-së, dhe ai i lëvizjes “Vetëvendosje”. Duhet kuptuar se jo çdo gjë është urgjente në këtë Kuvend, theksoi deputeti Ardian Gjini.

Myzejene Selmani, në emër të GP të Koalicionit Kosova e Re, tha se propozimet për futjen në rendin e ditës të shqyrtimeve të para të dy Projektligjeve, të hidhen në votim dhe për këtë të vendos Kuvendi.

Sasha Milosavljeviq, në emër të GP SLS, përkrahu propozimet për futjen në rendin e ditës të shqyrtimeve të para të dy Projektligjeve.

Albert Kinolli, në emër të GP “6+” përkrahu propozimet për futjen në rendin e ditës të shqyrtimeve të para të dy Projektligjeve.

Lidhur me propozimet e lartpërmendura diskutoi edhe deputeti Halit Krasniqi.

Pas këtyre diskutimeve kryetari ftoi në takim të përbashkët, kryetarët e grupeve parlamentare dhe ministrin e financave. Kryetari caktoi një pauzë prej 20 minutave.

Në vazhdim të mbledhjes plenare lidhur me propozimet e lartpërmendura diskutuan:

Ismet Beqiri - në emër të GP të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të GP të lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të GP të AAK-së, Adem Grabovci - në emër të GP të PDK-së, si dhe kryetari Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve kryetari ftoi në takim të përbashkët, nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare, për harmonizimin e qëndrimeve. Kryetari caktoi një pauzë prej 30 minutave.

Në vazhdim të mbledhjes plenare, **Adem Grabovci** - në emër të GP të PDK-së, propozoi që pika - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare**, të hiqet nga rendi i ditës deri në një marrëveshje me

Fondin Monetar Ndërkombëtar, ndërsa përkrahu edhe një herë, propozimet për futjen në rendin e ditës të shqyrtimeve të para të dy Projektligjeve.

Në vazhdim të mbledhjes plenare diskutuan:

Ismet Beqiri - në emër të GP të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të GP të lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të GP të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të GP të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Milosavljeviq, në emër të GP SLS, Duda Balje, në emër të GP ”6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve kryetari hodhi në votim së pari propozimin e deputetit Adem Grabovci për heqjen nga rendi i ditës së pikës - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.**

Kuvendi miratoi me shumicë dërmuese propozimin e lartë përmendur

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori

V E N D I M

Projektligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, të hiqet nga rendi i ditës derisa të bëhen konsultimet e nevojshme me Fondin Monetar Ndërkombëtar,

Më pas kryetari hodhi në votim propozimin për futjen në rend të ditës së seancës së sotme plenare të pikave:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ndërtim, dhe
3. Informatë e ministrit të Punëve të Brendshme për ngjarjen në kufi me Serbinë, më 31 mars 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 57,
Kundër----- 15,
Abstenime----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin e lartpërmendur.

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet sipas këtij rendi të ditës:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ndërtim,
3. Informatë e ministrit të Punëve të Brendshme për ngjarjen në kufi me Serbinë, më 31 mars 2012,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Bibliotekat në Republikën e Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lojërat e fatit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fondet pensionale në Kosovë,
8. Kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për tërheqjen e Projektligjit për

ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-168 për Turizmin dhe Shërbimet Turistike, 9. Shqyrtimi Planit Hapësinor i Zonës me interes të veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë”.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqes dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Ministri **Besim Beqaj** tha se ky Projektligj përcakton kornizën ligjore për pronësinë e ndërmarrjeve publike dhe qeverisjen e tyre korporatave në pajtim me parimet e njohura ndërkombëtare si dhe raportimin dhe përgjegjësinë për mbikëqyrjen e duhur të aktiviteteve të ndërmarrjeve publike.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri Beqaj i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Milosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli si dhe deputetët: Muhamet Mustafa dhe Sala Berisha – Shala, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi Xhavit Haliti, hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,

Kundër----- 16,

Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ndërtim

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqes dhe arsyetojë Projektligjin për ndërtim.

Zëvendëskryeministrja **Edita Tahiri** tha se ky Projektligj ka për qëllim të përcaktojë kornizën ligjore për lejet ndërtimore, pajtueshmërinë me kushtet e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda territorit të Republikës së Kosovës, llojet e ndërtimit, dokumentacionin për ndërtim, mbikëqyrjen inspektuese, gjobat dhe ndëshkimet si dhe dispozitat kalimtare.

Më pas ajo u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, zëvendëskryeministrja Tahiri i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për ndërtim.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndërtim.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nait Hasani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nijazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sali Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Milosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli si dhe deputetët: Suzana Novoberdaliu dhe Lutfi Zharku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ndërtim.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 57,
Kundër----- 15,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndërtim.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

3. Informatë e ministrit të Punëve të Brendshme për ngjarjen në kufi me Serbinë, më 31 mars 2012

Kryesuesi në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, ftoi ministrin të Punëve të Brendshme për paraqitjen e informatës.

Bajram Rexhepi, tha se 31 mars 2012, rreth orës 10:30 minuta, në fshatin Dumnice, në afërsi të lagjes Matarova, forcat policore serbe arrestuan dy zyrtarë të Policisë së Kosovës, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare të patrullimit, 120 metra në brendi të territorit të Republikës së Kosovës.

Ai në vazhdim tha se ky arrestim i zyrtarëve të Policisë së Kosovës ka qenë i organizuar për ti zënë në pritë policët tanë, ndërsa në ekzekutimin e këtij aksioni të shëmtuar të policisë serbe kanë marrë pjesë 12-13 policë të Serbisë.

Më pas ministri Rexhepi përshkroi emrat e pajisjeve të cilat i bartnin policët kosovar si dhe lidhjet e fundit me bazën, që policët tanë kishin pasur rreth orës 9:15 minuta, ndërsa informatën e parë për arrestimin e tyre tha se e kishin marrë rreth orës 14:00.

Më tej ministri paraqiti mënyrën e arrestimit të dy zyrtarëve policorë të Kosovës, dërgimin e tyre në një vend tjetër nga ana e forcave policore serbe, duke inskenuar situata dhe duke i fotografuar se kinse në atë vend janë arrestuar.

Më pas ministri tha se zyrtarët policorë të arrestuar janë intervistuar nga disa zyrtarë tjerë serb dhe janë dërguar para një gjykate serbe e cila u ka shqiptuar masën e ndalimit prej 48 orësh.

Ministri Rexhepi tha se pajisjet dhe vetura e zyrtarëve policorë të Republikës së Kosovës janë konfiskuar nga forcave policore serbe dhe të njëjtat deri më tash nuk janë kthyer.

Pas 48 orëve dy zyrtarët policorë kosovarë janë liruar dhe nën përcjelljen e zyrtarëve të EULEX-it, janë kthyer në Kosovë, ndërsa theksoi se zyrtarët policorë kosovarë nuk ishin të maltretuar fizikisht.

Ministri më pas u fokusua në procesin e hetimeve të cilat po zhvillohen nga Policia e Kosovës, nga mekanizmat ndërkombëtarë për çështje të sigurisë në Kosovë, si dhe nga KFOR-i.

Në fund ai paraqiti para deputetëve përfundimet që kanë të bëjnë me këtë rast.

Diskutimi i plotë i ministrit Bajram Rexhepi është dhënë i plotë në transkript.

Ahmet Isufi, në emër të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të FSK-së, tha se rasti i arrestimit të dy zyrtarëve policorë të Kosovës nga ana e forcave policore serbe, paraqet një agresion të Serbisë ndaj institucioneve të Kosovës, veprim antidemokratik dhe anti njerëzor.

Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se përgjegjësinë përgjatë vijës kufitare me Serbinë e ka KFOR-i, ndërsa syqeltësia e zyrtarëve policorë kosovarë është dashur të jetë më e madhe. Ne jemi partner që marrim përgjegjësi dhe obligime dhe veprimet tona duhet të jenë të matura dhe të koordinuara.

Anton Quni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se ndërhyrja e forcave policore serbe në territorin e Republikës së Kosovës në terminologjinë ushtarake njihet si agresion ndërsa kidnapimi i zyrtarëve policorë kosovarë njihet si akt kriminal. Ai më tej tha se është i pakuptimtë qëndrimi i institucioneve tona të sigurisë.

Blerim Shala, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se me 31 mars 2012 jemi munduar ti tregojmë botës se Serbia është vazhdimësi e së djeshmes së saj dhe se e ardhmja e raporteve ndërshtetërore është larg e të qenit e nivelit evropian.

Ne është dashur të merremi më shumë se çka është dashur të bëjnë institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se kërkojmë të punohet më shumë në aspektin e sigurisë dhe rendit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, ndërsa kërkojmë nga BE, NATO dhe SHBA-të, të ndërmarrin masa të rrepta kundër veprimeve serbe në Kosovë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi, Lutfi Haziri, Emin Gerbeshi, Agim Kuleta, Haki Demolli, Shaip Muja, Burim Ramadani, Sadri Ferati, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Xhavit Haliti, Vjollca Krasniqi, Hydajet Hyseni, Ganimete Musliu, kryetari Jakup Krasniqi, dhe ministri Bajram Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari konstatoi se debati për këtë pikë të rendit të ditës përfundoi.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Bibliotekat në Republikën e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Bibliotekat në Republikën e Kosovës.

Raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, e arsyetoi anëtar i këtij komisioni, deputeti, Idriz Vehapi.

Në vazhdim kryetari konstatoi se në mungesë të kuorumit nuk mund të procedojmë me votimin e amendamenteve të Projektligjin për Bibliotekat në Republikën e Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen plenare në ora 15:15 minuta.

Ndërsa vazhdimin e saj e paralajmëroi për ditën e nesërme, e premte 6 prill 2012, në ora 11:00.

6 prill 2012, e premte ora 11:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare të filluar më 29 mars 2012 dhe e vazhduar me 30 mars 2012 dhe 5 prill 2012.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Xhavit HALITI** nënkryetar Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 29 mars 2012, e vazhduar me 30 mars 2012 dhe 5 prill 2012. Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 68 deputetë.

Në vazhdim Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional- raportues për Projektligjin për Bibliotekat në Republikën e Kosovës, kanë përfunduar dje.

Për seancën e sotme kanë mbetur vetëm votimi i amendamenteve në këtë Projektligj, gjithsej 17. Në nenin 9 ishin propozuar dy amendamente, njëri nga Komisioni Funksional, ndërsa tjetri nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

Kryetari hodhi në votim amendamentet e propozuara, veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8A, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 53,
Kundër----- 16,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Bibliotekat.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional- raportues në Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve.

Raportin e Komisionit raportues-Komisioni për Punë dhe Shëndetësi, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Fikrim Damka.

Në këtë Projektligj ishin propozuar 13 amendamente nga Komisioni Funksional, ndërsa një (amendamenti nr. 2) ishte propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu.

Kryetari hodhi në votim amendamentet e propozuara, veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 73,
Kundër----- 5,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lojërat e fatit

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional- raportues në Projektligjin për lojërat e fatit

Raportin e Komisionit raportues-Komisioni për Punë Buxhet dhe Financa, e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, Safete Hadërgjonaj.

Në këtë Projektligj ishin propozuar 36 amendamente nga Komisioni Funksional, dy amendament (amendamenti nr. 7 dhe 47B) ishin propozuar nga Koalicioni për Kosovë të Re dhe 14 amendamente ishin propozuar nga deputeti Shaip Muja.

Kryetari hodhi në votim amendamentet e propozuara, veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15A, 16, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 32A, 33, 34, 35, 39, 42, 43, 44, 46, 47A, 48, 49, 50 dhe 52.

Kuvendi nuk miratoi këto amendamente: 3, 4, 15B, 17, 18, 31, 32B, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 47B dhe 51.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër----- 5,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për lojërat e fatit.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fondet pensionale në Kosovë

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional- raportues në Projektligjin fondet pensionale në Kosovë.

Raportin e Komisionit raportues-Komisioni për Punë Buxhet dhe Financa, e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, Safete Hadërgjonaj.

Në këtë Projektligj ishin propozuar gjithsej 50 amendamente nga Komisioni Funksional.

Kryetari hodhi në votim amendamentet e propozuara, veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49 dhe 50.

Në fund, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për fondet pensionale në Kosovë.

8. Kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-168 për Turizmin dhe Shërbimet Turistike

Kryetari njoftoi deputetët për kërkesën e Qeverisë për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-168 për Turizmin dhe Shërbimet Turistike.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti, kryetari Jakup Krasniqi, Ardian Gjini, Teuta Sahatqija, Shaip Muja, Arben Gashi, Armend Zemaj, dhe Hashim Dëshishku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari hodhi në votim kërkesën e Qeverisë për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-168 për Turizmin dhe Shërbimet Turistike.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve miratoi kërkesën e Qeverisë për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-168 për Turizmin dhe Shërbimet Turistike.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-168 për Turizmin dhe Shërbimet Turistike, i kthehet Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ripunim.

9. Shqyrtimi Planit Hapësinor i Zonës me interes të veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë”

Raportin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e paraqiti deputeti Nait Hasani.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nijazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sali Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sevdije Lama, si dhe deputetët: Ramiz Lladrovci, Haki Demolli, Sala Berisha – Shala, dhe Hasime Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Propozim-planin Hapësinor të Zonës me interes të veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë”.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 50,
Kundër----- 6,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Planin Hapësinor të Zonës me interes të veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë”.

Kryetari konstatoi të mbyllur punimet e mbledhjes së sotme, në orën 16:08 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Njësia për Mbështetje të Kryesisë dhe Mbledhjes Plenare